



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.76.

Prishtinë, më 16.4.2024, në orën 10:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204 .

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ardian Gola, Albena Reshitaj, Arijeta Rexhepi, Arjeta Fejza, Jahja Kokaj, Vlora Dumoshi dhe Adriana Matoshi, anëtarë.

Munguan: Enis Kervan, Eliza Hoxha, dhe Ardian Kastrati.

Pjesëmarrës tjerë: Arbërie Nagavci, ministre e MASHTI, përfaqësues të MASHTI dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi: Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve së mbajtura më 2.4.2024 dhe 12.4.2024;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit numër 08L/300 për provimin e maturës shtetërore;**
- 4. Diskutim për dinamikën e punës për Projektligjin për rini dhe sport;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve së mbajtura më 2.4.2024 dhe 12.4.2024

Procesverbalet e mbledhjeve së mbajtura më 2.4.2024 dhe 12.4.2024 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit numër 08L/300 për Provimin e Maturës Shtetërore

Ardian Gola, tha se për të propozuar konceptin e këtij projektligji sot e kemi të pranishme edhe ministren Nagavci, e cila do ta paraqes konceptin e këtij projektligji.

Arbërie Nagavci: Projektligj i cili ka qenë i paraparë në plan programin qeverisës së Kosovës, i hartuar në bashkëpunim edhe me akterët relevantë, Ministria ka finalizuar këtë Projektligj dhe i njëjti është aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës, më 2 prill të vitit 2024. Ky Projektligj përcakton statusin e provimit të maturës shtetërore në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës, përcaktimin e përmbajtjes, kushteve dhe mënyrës së organizimit të provimit të maturës shtetërore, të drejtat e kandidatëve, përcaktimin e strukturave përgjegjëse dhe kompetencat e tyre për organizimin e provimit të maturës shtetërore. Në procesin e hartimit të këtij projektligji janë përfshirë zyrtarë nga Ministria e Arsimit dhe Institucionet bartëse të Ministrisë si dhe ekspertë të arsimit. Janë analizuar dhe adresuar të gjitha komentet e pranuar, kemi paraparë disa ndryshime në këtë Projektligj, përfshirë caktimin e statutit të organizimit dhe strukturave përgjegjëse, riformulimin dhe plotësimin e provimit të maturës, ndryshimin dhe fuqizimin e Komisionit Shtetëror të maturës më anëtarë profesionalë, rregullimin e procesit të kundërvajtjeve dhe shkeljeve disiplinore. Ky projektligj do të ndikojë edhe në cilësinë e provimit dhe pritet që të përmirësohet në vazhdim.

Jahja Kokaj: Me kujdes të veçantë e kam lexuar Projektligjin dhe konstatoj se e meriton të aprovohet sot, por me shpresë që niveli i vigjilencës sidomos problematike tash në shekullin e teknologjisë informative është shumë lehtë të kontrabandojnë kalimin pa dije, besoj që në këtë aspekt do të ketë kujdes të shtuar, shpresoj që edhe në kuptimin e implementimit, pra në realizimin praktik të tij do të bëhet e mundur të rritet vigjilenca dhe me kredibilitet të arrihen rezultate pozitive.

Arijeta Rexhepi: Projektligji për provimin e maturës, është jashtëzakonisht me rëndësi, duke ditur deri më tani se si është mbajtur ky test dhe sfidat që i ka pasur që më qenë një proces sa më cilësor. Pyetja ime është se sa rregullon ky ligj mënyrën e cilësisë së organizimit të testeve të maturës, pra mundësinë e moskopjimit gjatë testit, përmbajtja e pyetjeve sa është planifikuar të rregullohet përfshirja e pyetjeve për shkollat profesionale dhe gjimnazeve përkatëse. Në ligjin aktual është vendosur përqindja për pranimin e nxënësve në arsimin e lartë, sa i keni analizuar këto përqindje, duke pasur parasysh që po të ishte shumë real testi i maturës, ndoshta do të kishim pasur një

arsimim të mirë, por duke e ditur se si ka shkuar deri më sot, a kemi nevojë të ndërhyjmë në përqindjen se sa për qind apo pikë të llogaritet testi i maturës. Ligji aktual thotë: digjitalizimi i provimit të maturës rregullohet me akt nënligjor, tek ligji i ri nuk është edhe pse kisha dashtë të mendojmë që provimi i maturës të jetë në formë digjitale që t'i largojmë këto mundësitë e kopjimit dhe manipulimit.

Arbërie Nagavci: Çështjet të cilat u shtruan kanë të bëjnë me menaxhimin e mirë të drejtë dhe parimor të provimit të maturës. Ajo që kemi bërë në këtë provimin e radhës, që nuk i përfshin edhe ndryshimet të cilat janë adresuar në ligj, është që kemi filluar pjesërisht digjitalizimin në aspekt të aplikimit online të sistemimit të nxënësve, mënyra se si ata do të vendosen në klasa, d.m.th. nuk do të jenë nxënësit e të njëjtës klasë në një klasë. Sa i përket çështjes së nenit i cili ka qenë specifikisht për digjitalizimin, ministria ka pasur një projekt të filluar diku në vitin 2013, për digjitalizim të arsimit, ndonëse formalisht që ai projekt konsiderohet i përfunduar nuk ka pasur asgjë konkrete në këtë pikë, sa i përket provimit të maturës. Aktualisht jemi duke synuar që nga ky vit të bëjmë aplikimin online të nxënësve dhe të dhënat t'i kenë në mënyrë elektronike dhe rezultatet e certifikata të bëhen në mënyrë publike.

Sa i përket shkollave profesionale, jemi duke e adresuar tek Ligji për aftësimin profesional është përfunduar koncepti dokumenti për atë ligj, dhe besoj që shpejt do ta votojë edhe Qeveria. Sfidat më të mëdha vazhdon të mbetet menaxhimi i suksesshëm, konkretisht moslejimi i kopjimit në këtë test.

Arjeta Fejza: Besoj që të gjithë jemi të vetëdijshëm për rëndësinë që e ka ky Projektligj, sidomos ne që kemi pasur edhe përvojën nga puna në shkolla, konkretisht në shkolla të mesme. Ajo çka dëshiroj të përgëzojë është përcaktimi i saktë i kompetencave të të gjitha institucioneve, të cilat kanë përgjegjësi në organizimin e testit të maturës. Ajo çka më bëri përshtypje është tek neni 6, ku është paraparë që përveç autoriteteve që janë ministria, Komisioni Shtetëror i maturës, drejtoritë komunale, shkollat e mesme si dhe Komisioni i Qendrës së provimit, është paraparë që të mund të themelohen edhe mekanizma të tjerë, të cilët do të ndihmojnë për procesin e organizimit të këtij provimi, çka është menduar në këtë nen konkretisht dhe cilat mund të jenë ata mekanizma që mund të ndihmojnë në këtë drejtim.

Arbërie Nagavci: Qëndron fakti se jemi munduar që me përcaktimin e saktë të kompetencave të adresojmë saktë edhe përgjegjësitë në mënyrë që gjithçka të realizohet sipas planifikimit, mekanizmat shpesh mund të ndërliken me çështjen e digjitalizimit, që është në synim dhe në të ardhmen, po përtej kësaj edhe në rast të bashkëpunimeve të nevojshme, sepse p.sh. në vitin e kaluar ne kemi pasur një bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Nxënësve, nuk kemi dashur të vendosim monitorues mbi monitorues, por jemi siguruar që të ketë një transparencë sa më të madhe dhe të ketë edhe një monitorim që të ndalojë kopjimi, përtej kësaj të tjerat do të adresohen edhe me udhëzime administrative.

Vlora Dumoshi: Vërtet, sot po diskutojmë për një Projektligj shumë të rëndësishëm. Ne vërejtjet dhe rekomandimet tona do ti japim në fazën e shqyrtimit të dy leximeve, do të propozojmë edhe amendamente që ta përmirësojmë cilësinë e këtij projektligji, uroj që ta hartojmë një projektligj sa më të mirë dhe t'i largojmë të gjitha ato probleme të cilat i kemi pasur për me vite.

Ardian Gola: Mendoj që është një Projektligj jashtëzakonisht i rëndësishëm në pikën të cilën duhet rimenduar, është pikërisht shpërndarja e përqindjes së vlerësimeve të nxënësve për tu sistemuar në arsimin e lartë, aktualisht ashtu siç edhe u cek komplet suksesi është 30% dhe 30% është edhe testi i maturës, dhe 40% testi pranues, ndoshta këtu do duhej të fokusohemi më shumë sepse këtu është gjeneza e njërit prej problemeve kyçe. Studentët janë gabimisht, madje edhe nga ambiciet që mund të kenë duke u futur në sistem pa pasur përgatitjet paraprake, përgatitje të cilat realisht marrin formë të vlerësimit numerik përmes përqindjes dhe nëse këtu do të kishim mundur të bëjmë një shpërndarje të mirë, besoj që do të kishim arritur të zgjidhim një problem serioz.

Arbërie Nagavci: Grupi i Punës, por edhe ne si Ministri e kemi bërë më të mirën të mundshme, janë shqyrtua gjithë komponentët edhe komentet të cilat i kemi pranuar, por natyrisht që është në kompetencat dhe mandatin tuaj si Kuvend që ta amendamenti ligjin. Ne mirëpresim secilin kontribut që mund të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së këtij projektligji.

Albena Reshitaj: Sot po flasim për një projektligj të rëndësishëm, kam pasur fatin që ndër vite të jem pjesë e provimit të maturës shtetërore në vëzhgimin e monitorimin e tij, prandaj i njoh në detaje edhe problemet e tij. Konsideroj që është momenti që të japim kontributin në përmirësimin e tij nëse ka nevojë. Meqë matura shtetërore është një provim përfundimtar, duhet të ketë disa mekanizma të monitorimit dhe kontrollimit edhe në regjione sepse ka pasur raste kur një regjion ka dalë shumë i suksesshëm dhe një regjion jo shumë i suksesshëm, në këtë test që nuk kanë qenë vlerësime shumë objektive ato dhe që ato kanë ndikuar më pas në përzgjedhjen e kandidatëve për studime dhe kjo ka qenë një e padrejtë që është bërë, një test i standardizuar dhe një trajnim i përgjithshëm që të ketë rezultate sa më të sakta, unë do të përkrah këtë ligj në parim me idenë që secili prej nesh do të kontribuojë në këtë projektligj.

Ardian Gola: Nëse nuk ka ndonjë koment tjetër ose pyetje po e hedhim në votim këtë projektligj;

Pas diskutimeve, anëtarët e Komisionit, me shtatë (7) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Projektligji 08L-300 për provimin e maturës shtetërore procedohet për lexim të parë në Kuvend.

4.Diskutim për dinamikën e punës për projektligjin për rini dhe sport;

Ardian Gola: Grupi Punës për Projektligjin për Sport është mbajtur sot dhe i ka dhënë disa orientime për dëgjimet publike të cilat janë të nevojshme që të krijohet një mundësi që kategoritë e grupeve të ndryshme të interesit të kenë mundësinë në procesin e shqyrtimit të projektligjeve. Si kryesues i Grupit të punës për Projektligjin nr 08L/277 për Sport, konsiderojmë që me datë 24.4.2024 t'i mbajmë dy dëgjime publike me dy kategori të ndryshme të interesit një dëgjim me

Drejtoritë Komunale të Sportit dhe një me Federatat, meqë janë shumë akterë të rëndësishëm në rregullimin e jetës sportive në Kosovë dhe mund të kenë më shumë komente.

Vlora Dumoshi: është me rëndësi që të përshihen të gjitha palët, edhe drejtoritë komunale kurse sa i përket federatave, është mirë që të ftohen edhe personat me aftësi të kufizuar dhe të diskutohet me të gjithë akterët, në mënyrë të shtruar që të kemi një projektligj sa më të pasur.

Arjeta Fejza: Në cilësinë e kryesueses së Grupit punues për Projektligjin për Rini, OSBE-ja ka shprehur gatishmërinë me mbështet këtë Projektligj, gjithashtu me grupin e deputetëve të rinj kemi diskutuar që edhe ata të ftohen në dëgjime publike. Mendojmë t'i organizojmë gjashtë dëgjime publike, sepse konsiderojmë që është e rëndësishme që projektligji të prezantohet sa më shumë tek të rinjtë dhe ata të kenë mundësinë të japin komentet e tyre në raport me projektligjin, andaj propozoj këto data me këto qendra: me datë: 26 prill, Dëgjim publik në Prishtinë, më 29, në Mitrovicë, më 3 maj, në Pejë dhe në Gjakovë, më 4 maj, në Gjilan dhe në Ferizaj dhe më 8 maj, në Prizren.

Ardian Gola: Për efekt të kohës, ndoshta është mirë që disa Dëgjime publike nëpër qytetet që janë afër të mbahen brenda një dite, në Gjakovë dhe Pejë brenda ditës.

Vlora Dumoshi: Formimi i Agjencisë për Rini, sipas saj nuk duhet bërë sepse e kemi të aprovuar edhe Strategjinë e rinisë e duhet me rishikuar, nëse i shohim subvencionet që Ministria e Kulturës i ka shpallë thirrjet për kulturë, ndërsa mbështetja për rini nga kjo qeverisje është shumë e paktë, pres nga këto dëgjime edhe komentet dhe ta bëjmë sa më të mirë këtë ligj,

5. Të ndryshme.

Ne këtë pikët të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën: 11:30

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Ardian Gola,

Kryetar i Komisionit